

KOMUNA E  
ÇAIRIT



ОПШТИНА  
ЧАИР

SEKTOR I REVIZIONIT TË BRENDSHËM-SEKTOR ZA VHATRESHNA REVIZIJA

Bul. Hristijan T. Karposh Nr. 5 | Бул. Христијан Т. Карпош бр. 5  
Tel: 02/2603-019 | faks: 02/2616-867  
info@cair.gov.mk | www.cair.gov.mk

Nr. / Бр. \_\_\_\_\_ prej / од \_\_\_\_\_ година

---

**PLANI VJETOR PËR REVIZION TË BRENDSHËM  
PËR VITIN 2014**

**Shkup, Dhjetor / 2013**

---

## Konstatime të përgjithshme

Në bazë të ligjit për Kontroll të brendshëm publik financiarë në Republikën e Maqedonisë (G.Z. 90/09). Rregulloren mbi mënyrën e punës, planit vjetor dhe programet për revizion të brendshëm (G.Z. 09/09), konstatohet që:

1. Planifikimi i revizionit të brendshëm përbëhet nga plani vjetor i revizionit dhe programi për revizion të brendshëm për çdo revizion që do të kryhet;
2. Më qëllim të planifikimit të punës së revizionit, revizori i brendshëm përpilon planin vjetor për revizion të cilin e verifikon dhe e nënshkruan Kryetari i Komunës;
3. Planin vjetor i miratuar më parë nga Kryetari i Komunës, dorëzohet në Ministrinë e Financave më së voni deri më 15 Dhjetor të vitit në vijim, për vitin e ardhshëm;
4. Udhëheqësi i njësisë për revizion të brendshëm me shkrim i njofton subjektet të cilët do të jenë subjekt i revizionit;
5. Planin vjetor i revizionit bazohet në parashikimin e rreziqeve eventuale në funksionimin normal të entiteteve potenciale për revizion, të verifikuara në bazë të të dhënave në procesin e identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve më të mëdha;
6. Gjatë planifikimit të punës në revizionin e brendshëm duhet të merren parasysh: përshkrimi-definimi i objektit për revizion, kohës së nevojshme për kryerjen e revizionit, personelin i cili do ta kryen revizionin, angazhimi eventual i ekspertëve të jashtëm për ndihmë gjatë procesit të revizionit;
7. Puna e revizorëve gjatë procesit të revizionit bazohet në: Ligjin për Kontrollë të brendshëm publik financiarë, rregullores dhe udhëzuesit për revizion të brendshëm, Standardeve ndërkombëtare për revizion si dhe Kodit të Etikës në punën e revizorit;
8. Revizioni i brendshëm në institucion mund të realizojë disa lloje të revizioneve:
  - a) Revizion të rregullshmërisë në punë;
  - b) Revizion të vlerësimit të sistemeve;
  - c) Revizioni të suksesit në punë; dhe
  - d) Revizion financiar.

## Plani i revizionit në Komunën e Çairit

Në bazë të konstatimeve të mëparshme, njësia për revizion të brendshëm në Komunën e Çairit për vitin 2014, ka miratuar këtë plan vjetor për revizion të brendshëm:

Nr. Rendorë	Lloji i Revizionit të mbrëndshëm	Subjekt i Revizionit	Qëllimi i Revizionit	Koha e planifikuar per Revizion	Zbatuesit	Ekspertë të Jashtëm
1.	Revizioni i rregullshmërisë	Përlllogaritja e saktë dhe complete e pagave të nëpunësve në Shkollat Fillore dhe Çerdhet për fëmijë në komunën e Çairit për vitin 2013.	Të shqyrtohet rregullshmëria e pagesave të pagave të punësuarve sipas rregulativës	1 Janar – 1 Mars	Ramadan Alija Xhevat Tahiri Agon Ajrulla	/

2.	Revizioni financiar dhe i rregullshmërisë	ÇF “Fidani” revizioni financiar dhe revizioni i rregullshmërisë për vitin 2013.	Menaxhimi I mjeteve financiare dhe përputhshmëria e punës në bazë të ligjeve	1 Mars - 30 Maj	1.Ramadan Alija Xhevat Tahiri Agon Ajrulla	/
3.	Revizioni i sukseshmërisë	Sukseshmëria e përmbledhjeve të të ardhurave, në mënyrë efikase dhe efektive, të bazuara në hyrjen e tatimit në pronë për vitin 2013	Të shqyrtohet efektiviteti dhe efikasiteti i sistemit për përmbledhjen e të hyrurave të tatimit në pronë	1 Qërshor – 1 Korrik	Ramadan Alija Xhevat Tahiri Agon Ajrulla	/
4.	Revizioni Financiar dhe revizion i rregullshmërisë	SHF “Hasan Prishtina” revizioni financiar dhe revizioni i rregullshmerise për vitin 2013	Menaxhimi I mjeteve financiare dhe rregullshëria e punës në bazë të ligjeve	1 Korrik– 30 Gusht	Ramadan Alija Xhevat Tahiri Agon Ajrulla	/
5.	Revizion i rregullshmërisë	Procesi i furnizimeve publike, gjegjësisht, procesi administrativ i furnizimeve publike në Komunën Çair për vitin 2013	Procedurat për furnizimet publike të jenë në pajtueshmëri me ligjet, nënligjet dhe aktet interne.	1 Shtator – 1 Nëntor	Ramadan Alija Xhevat Tahiri Agon Ajrulla	/
6.	Revizioni financiar dhe revizioni i rregullshmërisë	SHF “Imri Elezi” revizioni i rregullshmëri dhe revizionit financiar për vitin 2013	Menaxhimi I mjeteve financiare dhe rregullshmëria e punës në bazë të ligjeve	2 Nëntor - 10 Dhjetor	Ramadan Alija Xhevat Tahiri Agon Ajrulla	/

Kryetari i Komunës Çair

---

Izet MEXHITI